



Kompania Rajonale e Ujësjetësimit
"Hidroregjioni Jugor" SH.A.
"Vatrat Shqiptare", p.n. 20000 Prizren
Tel/Fax; 029/ 244-150 029/ 244-107
E-mail: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLESIT
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOOSNABEVANJE
» HIDROREGJIONI JUGOR « SH.A.D.D.
Nr. 01-46/01
Dt. 28.01- 2019
PRIZREN

Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësjetësimit "Hidroregjioni Jugor" Sh.A me seli në Prizren në përputhje me nenin 31(31.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 për raportet tremujore , në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2018 mori këtë:

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
Ceveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja
Ministry of Economic Development
Njësia Org. 01/3 Nr. Prot. 236
Org. Jedin. Br. Prot. No:
Org. Unit Prot. No:
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: - Data / Datum / Date: 06.02.19
PRISHTINË/A

RAPORTI – TM4-2018

Vendimi : 01-46/01

Bordi i Drejtorëve njëzëri miratoi raportin e TM4 për vitin 2018 në mbledhjen e XLII të mbajtur me datë 28.01.2019

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi Ekzekutiv Besim Baraliu	Kryesuesi i BtD Rexhep Manxhuka
Nënshkrimi		
Data	28.01.2019	28.01.2019





2018

REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO Çetësia e Kosovës / Млада Република / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Министерство Экономиког Развоља Ministry of Economic Development			
Projekti Org. Org. Kodit. Org. Uniti	01/3	Nr. Prot. Nr. Prot. Prot. Nr.	236
Nr. i fletëve Totali i fletëve Nr. paqesë	/	Data Data Date	06.02.19
PRISHTINE/A			

RAPORT-TM4- 2018




K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A
 Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000
www.hidroregjioni-jugor.com

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja Ministry of Economic Development			
Nësisia Org. Org. Jedin. Org. Unit	01/3	Nr. Prot. Br. Prot Prot. No:	236
Nr. i faqe ve Broj stranica No. pages:	—	Data Datum Date:	06.02.19
			PRISHTINË/A

PËRMBAJTJA	2
Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”	3
I. RAPORTI I SHËRBIMIT TEKNIK	4
1.1 KRU „Hidroregjioni Jugor“	
1.1.1 Situata e furnizimit – TM4 2018	4
1.1.2 Aktivitetet kryesore	4
1.1.3 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	12
1.1.4 Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	12
1.1.5 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	12
II. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË	13
2.1 KRU „Hidroregjioni Jugor“	13
2.1.1 Aktivitetet kryesore- TM4 2018	13
2.1.2 Raport i Ekipes së inspektimit dhe shqyçjes	13
2.1.3 Raport I ankesave teknike dhe komerciale	13
2.1.4 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	14
2.1.5 Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	14
2.1.6 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	14
III. RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIARË	15
3.1 KRU „Hidroregjioni Jugor“	15
3.1.1 Aktivitetet kryesore – TM4 2018	15
3.1.2 Arsyeshmëria e shpenzimeve	16
3.1.3 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	17
3.1.4 Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	17
3.1.5 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	17
IV DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV	18
V RAPORT NGA AUDIT. I BRENSTEM	31
VI PERFORMANCAT OPERATIVE DHE FINANCIARE – TM4- 2018	36
ORGANOGRAMI	41

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A

KRU" HIDROREGJIONI JUGOR" Sh.A Prizren Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit



LEGJENDA:	
04	Zona e shërbimit
05	Qytetet me ujë
60	Fshatrat me ujë që menaxhohen nga HRJ
131	Venbanimet pa shërbime të ujësjellësit

Punoi: Shërbimi TEKNIK

I. RAPORT I SHËRBIMIT TEKNIK

1.1.1 KRU ,, HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A – PRIZREN

1.1.1 SITUATA E FURNIZIMIT - TETOR – DHJETOR 2018

Furnizimi me ujë të pijes në nivel regjional ka qenë i rregullt, nëpër të gjitha njësitë punuese kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë.

Kompania ka arritur që në muajt Tetor – Dhjetor të vitit 2018 të furnizojë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në përjashtim të zonave të larta të cilat furnizohen me sistem të pompimit ku edhe kemi reduktime (kryesisht të lagja Dardanisë dhe në lagjen 2 Korriku ku përfshihen rruga e Janinës dhe disa rrugë tjera sekondare). Për me gjëresisht është prezente tabela e reduktimeve nga njesia Operuese ne Prizren. Sa i përket pjeses së Bazhdarhanës kryesisht banesave kolektive, jemi duke aplikuar ndryshime konform nevojës per konsum. Duhet cekur se ky ndryshim teknik është ende në provë dhe munde të kemi reduktime deri sa të finalizojmë projektin e planifikuar për ndarjen fizike te furnizimit të lagjen Dardania me lagjen Bazhdarhana, ku pas implementimit të këtij projekti lagja Bazhdarhana, lagja 2 Korriku dhe disa rrugë sekondare do të kenë furnizim të rregullt me ujë të pijes (Ky projekt eshte duke u financuar nga komuna e Prizrenit dhe implementimi i ketije projekti ka filluar gjate muajit Tetor te vitit 2017). Ju njoftojme se projekti i rezervuarit Shpati 2 i financuar nga Komunaa e Prizrenit është në fazën përfundimtare dhe pritet të vihet në funksion në muajin Janar të vitit 2019, me këtë rast do të menjanohen reduktimet për lagjen Dardania 2, lagjen Bazhdarhana dhe lagjen 2 Korriku. Në njësitë tjera operuese si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka probleme të theksuara të furnizimit me ujë të pijes mirpo duke u bazuar në raportet e njesive operuese kemi aplikuar reduktime të planifikuara në varesi të defekteve të mundshme si dhe ndërprerjeve të enrgjise elektrike nga KEDS (për me tepër gjeni si me poshtë raportet e Njesive Operative nga udheheqsit e Njesive).

1.1.2 AKTIVITETET KRYESORE

- * Takime ditore me Kryeshefin Ekzekutiv.
- * Vizite në punishte në të gjitha projektet të cilat janë duke u implementuar.
- * Takime javore në Impiantin e Ujërave të Zeza.
- * Takim me Konsulencen dhe me udheheqesin e zyrës për P.ZH z.Lumni Sallahu. Me temen progresi i punimeve në projektin e ITUZ-së.
- * Takim me Konsulencen p2m dhe konsulencen Dorsch Group. Me temen progresi i punimeve në projektin e ITUZ-së.
- * Takim me Bob/Inxhinierin rezident te projektit - p2m-Konsulenca
- * Takim ne MMPH, me Ministrin Makolli, ku u diskutuan mudësitë e financimit te projektit për zonat e sigurisë të 40 Burimet dhe mundësine e mbeshtetjes finnciare për TVSH-në e projektit të Ujërave të Zeza.
- * Takim ne MMPH, me Agim Radoniqin, ku u diskutuan plani per realizimin e projektit ne rrugen Janina.

- * Takim me Konsulencën P2m dhe Kontraktorin AQUALIA - Diskutim rreth menyrës së transportit të Llumit.
- * Takim me perfaqesuesit e larte te kontraktorit AQUALIA dhe Hidroterm, diskutim rreth progresit te ngadalshem te punimeve.
- * Takim me z Agim Radoniqi nga MMPH, per mundesine e kryerjes se obligimit prej 900.00 euro te mbetura nga fatura IPC nr. 11 te AQUALIA.
- * Korespondencat me KfW-ne me Elke Dulenkopf per kompletimin e dokumentacionit per pagesat ndaj kontraktoreve deri ne fund te vitit 2018. Dokumentacioni eshte kompletuar dhe eshte derguar per pagese ne KfW.
- * Takim me delegacionin e Bankes Gjermane per Zhvillim KfW, me Elke Dulenkopf dhe Uwe Aras, takim për progresin e punimeve në të gjitha projektet e financuara nga KfW.
- * Dalja në vendngjarje në fshatin Budakove për verifikimin e burimeve ujore në fshatin Budakove, prezent ishin perfaqesues të Autoritetit Rajonal te Pellgjeve Lumore ne MMPH, u kqyren burimet ujore dhe u perpilua proces verbali mbi kqyrjen e burimeve ujore nga ana e MMPH-se, mbetet te procedohet tek inspektoriati i MMH-së.
- * Dergimi i projekteve emergjente për financimin e mundshem nga teprica e buxhetit, kerkuar nga Fidaim Spahiu perfaqesues i NJPMNP pran MZHE-së.
- * Takim me mbikqyresen nga MMPH, kontraktorin DIAMANTI dhe stafin e Departamentit Teknik, për rojektin e rrugës Janina dhe Nëna Tereze, ku teme diskutimi ishte fillimi i punimeve për implemetimin e këtije projekti. Ne përcaktuam një mbikqyrës i cili do ti raportojë MMPH-së për zhvillimin e projektit.
- * Dalja në punishten e projektit të Gypit Shkarkues nga ITUZ deri në Lumbardh, projekti është duke u zhvilluar sipas dinamikës së dhënë në Planin dinamik, edhe përkundër pengesave nga banorët projekti është duke u zhvilluar si duhet.
- * Takim me konsulencen e Masave shoqeruese, për progresin e punimeve, dhe dakordimin e mënyrës së organizimit të kampanjës për senzibilizimin e konsumatoreve për projektin e ujërave të zeza në Prizren-ITUZ.
- * Përgaditja e Planit të Biznesit për vitin 2019, planifimimi i investimeve për vitet 2019-2021,
- * Dërgimi i dokumentacionit të kompletuar për aplikimin e lejeve ujore për burimet e reja të cilat në të ardhmen do të futen në përdorim për shkak të zgjerimit të zonës shërbyese në kuadër të KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A.
- * Vizitë në projektin e furnizimit me ujë për Komunën e Mamushës, projekti në fjalë është para finalizimit dhe deri në fund të muajit Nëntor do të finalizohet.
- * Vizitë në projektin e ndetimit të rezervoarit në rrugën e Novosejlanit, projekt i financuar nga komuna e Prizren-it, i cili do të mbulojë dhe ndajë fizikisht furnizimin me ujë për lagjen Dardania 1 dhe 2, si dhe pjesën e sipërme të lagjes Lurilla, ky projekt është në fazën finale dhe pritet të lëshohet në punë në fund të muajit Nëntor.
- * Dërgimi i projekteve në të gjitha agjencionet financuese të brendshme dhe të jashtme.
- * Skanimi dhe printimi i projekteve për Digene Manastirices dhe Dragaqines.
- * Takim në ARRU, me përfaqësuesit e ARRU-së për mundësinë e ndërrimit të tarifave për vitin 2019, për shkak të i mpaktit që mund të ken shpenzimet e ITUZ-së për vitin 2019.
- * Takim me Konsulencën P2m dhe Kontraktorin AQUALIA - Diskutim për progresin e punimeve dhe përmbajtjes së planit të ri dinamik të punimeve.
- * Korespondencat mbi kompletimin e dokumentacionit për Fazën 1 të punimeve, kolektorin kryesor në anën e djathtë të lumbardhit, ky kompletim ka të bëjë me përgaditjen e komplet dokumentacionit për fazën 1 në mënyrë që të mund të regjistrohet si aset i kompanisë.

- * Takim me perfaqesuesen e MMPH-se Myvedete Muja, per pergaditjen e dokumentacionit te duhur per mundesine e licensimit te burimit ujqor ne fshatin Budakove.
 - * Takim me mbikqyresen nga MMPH, kontraktorin DIAMANTI dhe stafin e Departamentit Teknik, për projektin e rrugës Janina dhe Nëna Tereze, ku teme diskutimi ishte finalizimi i projektit brenda vitit kalendarik 2018, ne i sqaruam disa pengesa nga banoret e lagjes, megjithate projekti eshte duke u zhvilluar sipas planit dinamik dhe deri ne periudhen raportuese kan perfunduar rreth 70% e punimeve.
 - * Marrja e pelqimit ne Ministrine e Infrastruktures per depertimin e rruges N25 tek projekti Eflent Pipe, i cili i hap rruge kontraktorit qe te filloje punimet menjehere.
 - * Takim me konsulencen e Masave shoqeruese, për progresin e punimeve, dhe dakordimin e vazhdimit te organizimit të kampanjës për senzibilizimin e konsumatoreve për projektin e ujërave të zeza në Prizren-ITUZ.
 - * Takim me perfaqesuesit e ARRU-se, per rishqyrtimin tarifor, ku u dakorduar qe te rishiqohet edhe njehere planbiznesi i miratuar qe eshte ende ne fuqi.
 - * Takim me perfaqesuesit e Konsulences per fazen V, takimi ishte ne cilesine e takimit njoftues, ku ne si kompani i prezantuam te gjitha nevojat dhe dokumentacionet qe ne i posedojme dhe qe jane relevante per Fazen V te prjektit.
 - * Vizitë në Komunën e Mamushes per projektin e furnizimit me ujë për Komunën e Mamushës, projekti në fjalë është para finalizimit dhe momentalisht jemi ne fazen testuese te Rezervoareve, dhe planifikojme qe muajin dhjetor te perfundoj analiza e rrjetit dhe ne muajin janar.
 - * Takim me delegacionin e Qeverise Gjermane, Ambasades Gjermane, GTZ-se dhe KfW-se, me temen progresi i projekteve te investuara nga qeveria Gjermane dhe progresi i tyre, u diskutua edhe per planifikimin e projekteve te cilat kan te bejne me paramarreveshjen financiare ne mes te Qeverise se Kosoves dhe Qeverise Gjermane kryesisht ne kemi ne e energjise se ripertitshme.
 - * Takim në ARRU, me përfaqësuesit e ARRU-së për mundësinë e ndërrimit të tarifave për vitin 2019, për shkak të i mpaktit që munde të ken shpenzimet e ITUZ-së për vitin 2019.
 - * Takim ne objektet e KfW-se ne Prishtine shqyrtimin e minutave te takimit per Fazen V dhe VI te projektit te ujerave te zeza per qytetin e Prizrenit dhe qeshtjeve te tjera administrative dhe teknike qe kan te bejne me fazen V dhe fazen VI te projektit, takimi ishte mjaft i frytshem dhe propozimet tona u mirpritin nga delegaconi i KfW-se, ne si HRJ propozuam qe ta kemi nje konsulence per te dy fazat dhe ne aspektin teknik propozuam qe te kemi mundesi te furnizimit me nja kamion te madh me pompe shtytese dhe nje te vogel qe do tu pershtatet rrugeve te ngusa te qytetit, poashtu u dakorduar qe te furnizohemi edhe me nje CCTV-kamere per incizimin e rrjetit te kanalizimit.
 - * Projektet e financuara nge Qeveria Zviceriane dhe projektit të Eficiences së Energjisë Elektrike të financuar nga KfW, raportet perkatese janë proceduar nga Menaxheret e ketyre projekteve Zenel Zenelaj dhe Aranit Ukimeri.
 - * Sa i përket projektit te Ujerave te Zeza, konkretisht Fazes 1 dhe Fazes 2 te projektit, ju njoftoj se Faza 1 e projektit që ka të bëjë me Ndërtimin e kolektorit në anën e majtë të Lumbardhit, ka përfunduar komplet, tani jemi në fazën e përgaditjes përfundimtare të dokumentacionit të cilin do ta dorezojmë në arkive dhe në shërbimin për kontabilitet në menyre që të regjistrohet si aset i Kompanisë, kurse sa i përket Fazës 2 të projektit, tani me kemi hyre në fazën përfundimtare dhe sipas planit dinamik të rishikuar, punimet do të përfundojnë në Mars të vitit 2019.
- Për më tepër kemi në dispozicion Raportet Mujore dhe Tremujore si dhe për çdo gjë tjetër munde ta kontaktoni Kryetarin e Komitetit të këtijë projekti Lulzim Paçarizi dhe Anetarin e këtijë komiteti Lumni Sallahun.

Prodhimi i ujit m³ - Tetor-Dhjetor, 2018

Muaji	Prodhimi mujor m3	Prodhimi ditor- m3	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	3,036,700.00	33,007.61	382.0	
Suharekë	499,660.00	5,431.09	62.9	
Dragash	229,929.00	2,499.23	28.9	
Malishevë	356,952.00	3,879.91	44.9	
Total	4,123,241.00	44,817.84	518.7	

Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / Tetor-Dhjetor, 2018

Njësia Operative	Ujësjiellësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	475	133	608
Suharekë	87	42	129
Dragash	13	08	21
Malishevë	133	52	185
Total	708	235	943

Zyra për planifikim dhe zhvillim – Tetor - Dhjetor, 2018

Për periudhen që po raportojme në kuader të zyrës së Plan Zhvillimit grupet e organizuara të cilat veprojnë në teren kanë vazhduar bllombimet e ujëmatësive nëpër qytetin e Prizren-it, ku kanë arritur këto rezultate:

- Kontrata dhe bllombime 544 kontrata.
- Konsumatorët që ekipa jonë nuk ka pasur qasje 1,249 konsumator.
- Ribllombim 772.
- Pa ujëmatës 150.
- Kërkesa nga konsumatorët 34.
- Regjistrim i ri 48.
- Zevendesim 30.
- Kërkesa nga konsumatorët D.M 03.
- Bllombime me kontrollën 05.

	Prizren Total –Gjithsej	Total
1	Bllombim-Kontrata	544
2	Dera Mbyllur(Heren e dyte)	1,249
3	Pa ujëmatës	150
4	Ribllombim	772
5	Regjistrim i ri	48
6	Kërkesa nga Konsumatorët	34
7	Zevendesime	30
8	Kërkesa nga konsumatorët	03
9	Bllombime me kontrollën	05

AKTIVITETET KRYESORE

- * Përpilimi i raportit mujor, Tetor - Dhjetor 2018.
- * Takim pune në Prishtinë me CDI-në.
- * Takim pune në Prizren me CDI-në.

- * Takim në K.R.U “Prishtina” – Prishtinë për planin e Investimeve Afatgjata.
- * Koferenca e ujërave në Tiranë – Shqipëri.
- * Përpilimi i planit të Investimeve Afatgjata.
- * Mbikqyrje e punimëve në projektin e MMPH në rrugët “Janina” dhe “Nënë Tereza” – Prizren.
- * Mbikqyrje e projektit të CDI-së nëpër zonat rurale të Prizren-it.
- * Grupi i bllobimit është angazhuar në fshatrat: Lutogllav dhe Malsi e Re ku kanë arritur këto rezultate: 120 bllobime, 114 pa ujëmatës, 49 me puse, 04 të mbuluar me dhe, 06 shtëpi në ndërtim dhe 83 konsumator që ekipa jonë nuk ka pasur qasje.
- * Grupi i demontim-montimit është angazhuar në fshatin Medvec për instalimin e ujëmatësve tek konsumatorët ku kanë bërë: 39 vizita të konsumatorëve si dhe 12 instalime të ujëmatësve.
- * Gjatë muajve Tetor – Dhjetor grupi ka vazhduar me perpunimin e te dhenave të terrenit, vendosjen e te dhenave në GIS.

Në këto muaj kemi filluar vendosjen (vizatimin) e kyqjeve shtepiake (ujësjellës dhe kanlizim) si dhe ujëmatësve në Gis ku për secilin layer do të vendosen të dhënat specifike si plotesimi i attributeve të nevojshme si dhe vizatimi nga gypi kryesor deri tek ujëmatësi.

Gjithashtu është mbajtur një takim nga Sherbimi Teknik në lidhje për MMS ku secila njesi do të fillojë që ta përdor këtë aplikacion për operimin dhe mirëmbajtjen e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Trajnimi është mbajtur në zyrat e Departamentit Teknik nga ana e Konsulencës dhe Departamentit të Gis-it ku nga muaji i ardhshëm do të fillojnë që ta përdorin këtë aplikacion.


MMS(Maintenance Management System) aplikacion i ndërtuar nga ana e Sherbimit Teknik në bashkëpunim me Konsulencën është e gatshme për përdorim ku të gjitha kërkesat dhe ankesat merren apo kanë një direkt-lidhje (link) ku për secilin kërkesë/ankesë bëhet një urdherese e punës në formë digjitale i cili si aplikacion mundëson operimin dhe mirëmbajtjen me të lehtë, gjenerimin e raporteve, numrin e orëve të puntoreve, numrin e orëve të makinerisë së angazhuar e shumë gjëra të tjera ku do të ekzistojë një raport i vecantë për këto.

Databaza e konfiguruar nga ana e Sherbimit Teknik dhe MMS-Tool çdo ditë bëhen backup dhe ruhen në serverin e Kompanisë dhe në një Hardisk të jashtëm për rast sigurie.

Departamenti i Gis-it ka bërë lidhjen me serverin e faturimit (së bashku me kompaninë e cila e menaxhon) ku kjo lidhje është direkte me tabelën `billing_properties` në kolonën `blockmappingId` ku tani e tutje çdo konsumator i ri që do të regjistrohet do të plotësohet edhe kjo fushë, numer i cili do të merret nga Departamenti i Gis-it, gjithashtu edhe konsumatorët të cilët nuk janë lidhur me faturimin janë duke u refreshuar dhe duke u plotësuar në kolonën `blockmappingId`.

Për refreshimin e konsumatorëve të cilët nuk janë lidhur me faturimin është krijuar një plan ku çdo inkasant në zonën të cilën ai punon vjen në mëngjes në zyrat e Departamentit Teknik dhe së bashku me operatorët e Gis-it vendosin lidhjen e konsumatorit në mes tabelës së faturimit me tabelën e konsumatorëve nga ana e Departamentit të Gis-it ku në këtë muaj janë përfunduar rreth 1000 konsumatorë.

Në vazhdim po i paraqesim disa karakteristika për rrjetin e kanalizimit (Numri i pusetave për secilin njesi)



NR	LOCATION	No.MANHOLE
1	PZ	3903
2	SR	573
3	MA	222
4	DR	48
TOTALI:		4746

Gjithashtu është vazhduar me matje me GPS në qytetin e Prizren-it ku janë perfunduar 100% të matjeve ku tani konsiderojmë që të gjitha e dhenat për pusetat dhe gypat e kanalizimit janë marre. Këto të dhëna janë strukturuar në databazën e konfiguruar në serverin e kompanisë ku secilit përdorues të GIS-it ju është mundësuar qasja në databazë Postgis si dhe në hapësirën punuese QGIS, këto dy hapësira janë të nderlidhura mes vete gjë që ka mundësuar përfshirjen e shumë përdoruesve në të njëjtën kohë.

* Kontrollimi i D.B, verifikimi i shënimeve të D.B me exel-shenimet e konsumatorëve, punë me MMS për operativen, gjetja e rekordeve në hartë me inkasantët, rregullimi i ujëmatësëve në GIS si dhe pregaditja dhe printimi i formularve për teren.

* Në muajt Tetor - Dhjetor, grupi i terrenit demontim – montim me njësi në Prizren kanë arritur që gjithsej të demontojnë dhe montojnë 275 ujëmatës, ekziston raporti i veçant si dhe lexim të ujëmatësëve.

* Grupi i detektimit të rrjetit të ujësjellësit gjatë muajit Tetor - Dhjetor, ka bërë gjithsej 178 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 105 defekte, ekziston raporti i veçant. Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 6,440 m.

* Leximi i ujëmatësëve zonal për muajin Tetor - Dhjetor, ujëmatësat në pikat matëse: Të KFORI vend i papërshtatshëm, Jusuf Gërvalla, të ETC-ja, Atmaxhë, Gorozhup kemi lexim të ulet të ujëmatësëve (ku të ETC-ja kemi bllokim të ujëmatësëve dhe Atmaxhë Baypass), Kojush II dhe Gjonaj i poshtëm i kemi ujëmatësat e demtuar (xhami i ujëmatësëve dhe koka e ujëmatësëve), Plane, Shkoz, Vërmic rruga e bllokuar për shkak të borës, Kobaj, Nashec i epërm, Tupec dhe Grazhdanik i kemi pusetat me ujë, Vlashnje dhe Landovicë skemi lexim të ujëmatësëve. Pikat tjera janë nën monitorim dhe janë në gjendje të rregullt për këtë muaj.

* Poashtu në këtë muaj kemi pasur një rast për riparimin e ujëmatësëve që janë sjellë nga vet konsumatorët, ekziston raporti i veçant.

Shërbimi i mirëmbajtjes - Servisimi i ujëmatësave: Tetor - Dhjetor, 2018

Ky shërbim bën servisimin dhe kalibrimin ujëmatësave të profileve $\Phi(13-100)$ mm.

Njësia Operative	Profili \emptyset mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	61	
	3/4"	171	
	1"	15	
	5/4"	01	
	6/4"	01	
	Gjithsejt:	249	
Suharekë	1/2"	00	
	3/4"	00	
	5/4"	00	
	Gjithsejt:	00	
Dragash	1/2"	00	
	3/4"	00	
	1"	00	
	Gjithsejt:	00	
Malishevë	1/2"	07	
	3/4"	28	
	1"	01	
	Gjithsejt:	36	

Totali: 285 copa

- Leximi i ujëmatësave 2 herë në muaj.
- 17 Ekspertiza

Raporti i aktiviteteve dhe analizat bakteriologjike Tetor – Dhjetor, 2018

Aktivitetet :

- * Kontrolli i Cl-rezidual në të gjitha pika të furnizimit, kontrolli i paisjeve dhe procesi i klorifikimit në stacionet e klorifikimit si dhe kontrolli i rregullt i burimeve dhe sasisë së ujit.
- * Furnizimi i përhershëm i fshatrave me Hipoklorur të Natriumit.
- * Marja e mostrave sipas programit në kroje në Qytet dhe zona rurale si në njësi ashtu edhe në regjion si dhe në burime.
- * Përcjellja permanente e klorit residual në kroje .
- * Përcjellja permanente e gjendjes së ujit në burime - cilsia , sasija etj.
- * Përcjellja pëmanente e stacioneve të klorifikimit dhe intervenimet e duhura për sanimin e problemeve gjatë procesit të klorifikimit.
- * Furnizimi i fshatrave me Hipoklorur Natriumi.
- * Marrja e mostrave në pikat e parapara sipas Planit të Monitorimit.
- * Në Prishtinë ishim në një puntori të organizuar nga zyra zvicerane në kuadër të Programit mbështetës për Ujësjetës dhe Kanalizime në zonat Rurale .

- * Në stacionin e klorifikimit në „Bunar-1”bëmë riparimin e injektorit i cili ishte jashtë funksionit.
- * Në stacionin e klorifikimit në „Mulliri i Vjetër ” riparuar gypin e klorit dhe servisimin e injektorit në Ø600.
- * Sërish në stacionin e klorifikimit në „Bunar-1”bëmë servisimin e tërë sistemit të klorifikimit pas dëmeve që na u shkaktuan nga amortizimi i disa pjesëve fazonike të cilat po na shkaktojnë problem në mbarvajtjen e procesit të klorifikimit.
- * Patëm defektë në injektorin në „Bunar-1” edhe atë në gypin ku bahet injektimi për rezervuarin e kalas ,të cilin e dërguam te mjeshtri për ta bërë riparimin e tij me qëllim të mbarvajtjes së rregullt të procesit të klorifikimit.
- * Problem patëm edhe në sistemin e klorifikimit në stacionin „Mulliri i Vjetër”,ku bëmë disa intervenime në pjesët fazonike të aparaturave të klorit.
- * Në KRU„GJAKOVA”ishim për trajnim mbi „MOSTRIMIN”si aktivitet i domosdoshëm në kuadër të punës së laboratorit dhe pregaditjeve për akreditim të laboratorit,të organizuar nga SHUKOS dhe IKSHP.
- * Në stacionin e klorifikimit në “Bunar-1 “ kemi bërë riparimin e disa pjeseve fazonike para injektimit të klorit edhe atë konkretisht në gypat Fi-400 dhe Fi – 300.
- * Jemi furnizuar me Klor Gas dhe Hipoklorur Natriumi për periudhen dy (2) mujore.

VEREJTJE :

Gjatë këtij muaji kemi pasur probleme të mëdha me AUTOMJET.

Analizat Bakteriologjike Laboratori “Hidroregjioni Jugor “ Prizren , Tetor - Dhjetor - 2018

Njesia	Lloji i ujit	Nr.i mostrave	Nr.i Mostrave qe nuk pergjigjen
Prizren	Burim	12	0
	Ujesjelles	34	0
Suhareke	Burim	2	0
	Ujesjelles	6	3
Dragash	Burim	3	0
	Ujesjelles	7	0
Malisheve	Burim	0	0
	Ujesjelles	7	1
Totali		71	4

Analizat Bakteriologjike, ISHP - Prizren Tetor - Dhjetor/2018

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	02*	00
	Ujësjiellës	210	00
Suharekë	Burim	02*	00
	Ujësjiellës	28	02
Dragash	Burim	02*	00
	Ujësjiellës	10	00
Malishevë	Burim	02*	00
	Ujësjiellës	25	00
Totali		281	02

*janë analizat e burimeve.

Numrin total i analizave në ujësjiellës 273 dhe dy nuk i përgjigjet standardeve.

1.1.3 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Keqpërdorimi i ujit të pijes.
- Ndërprerja e herë pas herëshme e energjisë elektrike.
- Shpenzimet e mëdha të energjisë elektrike.

1.1.4 MASAT E REALIZUARA / MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Te gjitha defektet ne sistem te ujesjellesit dhe kanalizimit jane sanuar me kohe,
- Eshte percjell ne menyre permanente cilesia e ujit te pijes ne nivel regjional,
- Eshte pergaditur dhe miratuar strategjia e UPF-se.

1.1.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

- Monitorimi i furnizimit me uje te pijes ne gjith zonen e sherbimit,
- Monitorimi i cilesise se ujit te pijes ne nivel regjional,
- Vazhdimi i analizes se rrejtit te ujesjellesit dhe bartja e te dhenave ne GIS,
- Fillimi i implementimit te strategjise per uljen e UPF-se.
- Aktivitet e shërbimit teknik të ndermarrur për eliminimin e humbjeve teknike.
 - ✚ Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.
 - ✚ Rehabilitimin e rrjetit te vjeter te qytetit per eleminimin e hubmjeve teknike – dedektimi i rrjetit te ujesjellesit dhe ndarja e zanave per dedektim.
 - ✚ Senzibilizimin e te gjithë konsumatoreve per mos keqperdorim te ujit te pijes permes, fletpalosjeve, informatave mediale dhe atyre te shkruara.
 - ✚ Ngritjen e vetedijes te te gjithë konsumatoreve qe ta paguajn ujin ne menyre qe te rritet inkasimi dhe te kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatoreve ne sherbime dhe investime per sherbim sa me efikas te furnizimit me uje te pijes.

II. KOMENTET NGA SHËRBIMI PËR KONSUMATOR

2.1 KOMENTET NGA SHËRBIMI PËR KONSUMATOR - KRU

2.1.1 Aktivitetet kryesore

Është bërë leximi i ujëmatësve nga inkasantët (lexuesit) e terrenit .

- Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellsit mbrenda afatit ligjor te secili konsumatorë.
- Janë shtyp 269 fatura më tepër si rezultat i rritjes së konsumatorëve në zonën e shërbimit .
- Janë vizituar nga inkasantët të gjithë konsumatorët në pronat e tyre ku janë shpërnda faturat dhe është kërkuar inkasimi i mjeteve për shërbimet e ujësjellsit .
- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike dhe komerciale të konsumatorëve

2.2.2 Raport i Ekipes se kontrolles dhe shkyqjes

Njesia Operative	Lidhjet e reja/legalizime	Shkyqjet	Lidhje jasht orës	Vërejtje për borxhe/përmbarrim	Verifikimi i ujëmatësve
Prizren	1381	75	72	9995	2472
Suharekë	220	28	30	775	3710
Malishevë	375	29	15	1443	1166
Dragash	3	0	0	26	0
KRU "Hidroregjioni Jugor"	1979	132	117	12239	7348

- Janë vizituar nga ekipet e kontrollës konsumatorët për mospagesë të shërbimeve të ujësjellsit, të cilët nuk paguajn faturat dhe atyre që kanë borxhe të mëdha ndaj KRU “ Hidroregjioni Jugor” sha. Secilit konsumatorë të vizituar nga ekipet e kontrolles i është lënë procesverbali ku ceket borxhi dhe afati për pagesën e borxhit.
- Janë bërë kontrole në teren te konsumatorët nga ekipet e kontrollës edhe për shqyrtim të ankesave të konsumatorëve dhe regjistrime të konsumatorëve të rinj.

2.2.3 Raport i ankesave teknike dhe komerciale

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	463
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	463
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	247
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	247
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	247

2.2.4 Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe

- Vazhdon mos zgjidhja e problemit të rasteve sociale, kjo kategori e konsumatorëve po ndikon në mungesën e inkasimit të kësaj kategori e konsumatorëve.
- Pamundësia e leximit të ujëmatësve për çdo muaj të një numër i konsumatorëve, nga inkasatë tek shtëpit (pronat) e konsumatorëve, pasi në kohën kur bëhet leximi nuk gjenden në shtëpi apo edhe nuk i hapin dyert për t'iu mundësuar inkasatëve leximin e orëve (kryesisht të konsumatorët që jetojnë në ndërtesa kolektive-banesa).
- Moszgjidhja e qeshtjes se borxheve të meherhshme, trashëgimi i borxheve në pronat e konsumatorëve
- Problemet e vazhdueshme me softver nga pamundësia e gjenerimit të raporteve sipas kërkesave tona.
- Faturat e medha mujore të disa konsumatorëve si rezultat i rrjedhjeve mbrenda ujëmatësit dhe pamundësia e pagesës së tyre
- Moszgjidhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpura që nga pas lufta, pronat që kanë qenë nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Pronës.

2.2.5 Masat e realizuara/ mosrealizuara nga periudha paraprake

- Rritje të numrit të konsumatorëve në zonën e shërbimit si rezultat i legalizimit të konsumatorëve ilegal apo edhe pëlqimeve për kyqje.
- Rënie e konsumit si rezultat i rënies së konsumit sezonal
- Rënie në inkasim si rezultat i sezonit.

2.2.3 Masat e propozuara për periudhën në vazhdim

- Vazhdimësi e thirrjeve me telefon dhe dërgimi i mesazheve përmes telefonit të konsumatorët të cilët nuk i përmbahen kontratës.
- Dërgimi i vërejtjeve për ndërprerje të shërbimit të konsumatorët pa ujëmatës.
- Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në teren, shpërndarja e paralajmërimeve para inicimit të rasteve të përmbauresi duke i ndërruar terrenet e inkasatëve.
- Vizita më të shpeshta të konsumatorët e bizneseve të cilët kanë borxhe, ata të cilët kanë bërë kontratë e të cilët nuk i përmbahen pagesës së kisteve.
- Vazhdimësia e mbështetjes së inkasatëve nga ekipi i kontrolles të konsumatorët të cilët në vijimësi nuk paguajn faturat
- Mbikqyrja dhe monitorim i vazhdueshëm i inkasatëve në arritjen e limitive në inkasim
- Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që dëshirojnë të kyqen në shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit.

III. AKTIVITETI I SHËRBIMIT FINANCIAR TM4 – 2018

3.1 KRU „ HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

3.1.1 *Aktivitetet e nga departamenti financiar për TM4-2018*

Ky raport përfshinë të gjitha aktivitetet nga shërbimi financiar në pika të shkurtra, aktivitete të cilat janë konform rregullores së punës së kompanisë si dhe ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga regjistrimet e rregullta dhe të drejta sipas ligjeve në Kosovë e deri te aktivitetet tjera për një performacë sa më të mirë të kompanisë, dhe disa nga to janë:

- Regjistrimi i arkave në bazë ditore, regjistrimet furnitorëve, depove si dhe aseteve për muajt përkatës.
- Kontrollimi dhe barazimi i të pagueshmeve dhe atyre të arkëtueshmeve,
- Prgatitja e raporteve mujore, si inkasimin, të hyrat dhe ato të shpenzimeve, gjithashtu edhe raportet tremujore;
- Hapja dhe prgatitja e pagave për muajtë përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrit të të punsuarve;
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisrisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, si dhe aprovimi i tyre për blerje;
- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;
- Pagesa e furnitorëve, pas kontrollimit të blerjeve;
- Plotesimin e librave të blerjes dhe shitjes sipas formës standarte të kërkuar nga ATK, për muajtë përkatës, mujor e tremujor;
- Deklarimet e tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave etj, sipas ligjeve në fuqi;

3.1.2 ARSYESHMËRIA E SHPENZIMEVE

KRU „ HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A- PRIZREN

TM4- 2018

Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e IV-të 2018, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të III-të 2018, janë më të larta, por edhe performanca është e kënaqshme, falë inkasimit dhe angazhimit më të lartë.

Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsytet e rritjes apo uljes së tyre;

Pozicioni i shpenzimeve të pagave, në këtë pozicion, kemi një rritje të shpenzimeve. Kjo rritje ka ardhur sidomos nga dy muajtë e fundit, nëntor dhe dhjetor, për shkak se kemi dhënë shtesa për festat e fund vitit sipas vendimev, pra kjo ka ndikuar në rritje të shpenzimeve për paga.

Ndërsa te pozicioni i energjisë elektrike, kemi një rënje të lehtë të shpenzimeve totale në krahasim me tremujorin e III-të, sidomos te njësia e Suharekës dhe Malishevës;

Por, te pozicioni i derivateve kemi një rritje të shpenzimeve, tek të gjitha njësitë ka lëvizje të këtyre shpenzimeve, për shkak në këtë kategori janë të futura edhe shpenzimet për dru, tani sezonin e dimrit kemi në përdorim edhe ngrohjen qendrore, për të cilën kemi hargjim të naftës, pra këto janë arsytet edhe për rritje totale të këtyre shpenzimeve;

Edhe te pozicioni i mirëmbajtjes dhe riparimeve, dhe mirëmbajtjen e pompave, kemi një rritje, por jo shumë sa mund të ketë ndikuar në rritje të shpenzimeve totale. Por nevoja për intervenime në rrjetet ka qenë më e lartë;

Rritje kemi edhe te pozicioni i mirëmbajtjes së automjeteve të këtyre shpenzimeve, pasi mirëmbajtja e tyre ka qenë më pak e nevojshme në këtë tremujor;

Shpenzimet e taksave janë pothuajse të njejta, me tremujorin e kaluar, pasi që shpenzimet për taksat e përmbaruesit kanë qenë aty afër me tremujorin e kaluar, ndërsa shpenzimet e anëtarësisë në SHUKOS edhe ato të ARRU-së mbetën të njejta;

Shpenzimet tjera, ku përfshihen shpenzimet e administrates, shpenzimet e telefonisë, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, etj, kemi një rritje të këtyre shpenzimeve, sidomos shpenzimeve të administratës, sepse kemi bërë blerje të faturave për konsumatorë për disa muaj;

Pra si përfundim, shpenzimet për këtë tremujor kanë qenë më të larta në krahasim me tremujorin e kaluar, për arsytet e cekura më lartë, pra pozicioni i pagave është më i lartë, për arsytet e cekura më lartë, por që performanca edhe në këtë tremujor është e mirë;

3.1.3 Problemet e hasuara gjate kersaj periudhe

- Edhe pse faturimi ne kete periudhe ka qene me I ulet ne krahasim me TM3, inkasimi ka qene ne nivele te lart krahasuar me shumen e faturuar ne masen prej 107.31 %. Problemet e hasura gjat kesaj periudhe jane te nryshme sidomos pamundesia e inkasimit te borgjeve per shkak te rasteve sociale te disa konsumatoreve. Numri I madhe I konsumatorve qe nuk paguajn fare eshte I larte ,nga arsyet e ndryshme.
- Sa I perket shpenzimeve , ato jane rritur ne kete periudhe sidomos rritje kan patur pagat per shkake se jane dhene shtesa per funde vitin 2018.
- Problemi I pagesave te borgjeve ndaj operatoreve ekonomik ekzistone per shkak te marreveshjeve qe I kemi me CDI si dhe me Kuvendet komunale , te cilet kane marre obligim per financim te projekteve te caktuara,e te njejtit nuk I kan perfunduar obligimet e veta.

3.1.4 Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake

- Jane ndermarre masa te konsiderueshme ne inkasimin e borgjeve te konsumatoreve dhe per kete edhe eshte rrite inkasimi ne kete periudhe per 8.84%.
- Jane zvogluar shpenzimet e energjis elektrike per 2.91%
- Dergimi I lendeve te kompletuara tek Permbaruesi per konsumatorët e pandergjegjsjem.

3.1.5 Masat e propozuara per periudhen ne vazhdim

- Te rritet faturimi I konsumatoreve ne baze reale te konsumit sipas ujmatesve.
- Te zvogelohen shpenzimet operative te Kompanis sidomos ato te karburanteve ,energjiia elektrike etj.
- Te pegaditen dhe te kompletohen lendet pet tek permbaruesi ,per konsumatorët e pandergjegjsjem.

IV. Shërbimet e përbashkëta në Departamentin e administratës

Departamenti i administratës gjatë këtij tremujori është marr me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

- Gjatë këtij tremujori janë përgatitur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dala nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, komiteti i financave, dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Pas përgatitjes së Procesverbaleve të Bordit, Komisionit të Auditimit dhe të komiteteve, janë njoftuar të gjitha shërbimet (udhëheqësit) lidhur me rekomandimet e Bordit dhe raportet e kërkuara nga mbledhjet në fjalë.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga fusha e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Aktvendimet për pushime vjetore janë lëshuar pas kërkesës me shkrim të punëtorëve dhe aprovimin apo pëlqimin nga udhëheqësit e tyre.
- Me autorizim të KE janë përgatitur Vendime për mbikëqyrje të punimeve dhe pranim teknik te punimeve për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave të njësive punuese sipas kërkesës së shërbimit teknik.
- Me Vendim janë formuar Komisionet për regjistrim vjetor 2018 që përfshin: Komisioni për regjistrimin e mjeteve themelore, veglave të rënda dhe inventarit të imët; Komisioni për regjistrimin e lëndëve të para dhe materialit në depon kryesore dhe në servis të bazhdarimit; Komisioni për regjistrimin e arkës, porto-arkën, kërkuesit dhe blerësit dhe Komisionin Qendror të regjistrimit. Të gjithë komisionet e regjistrimit do të kryejnë regjistrimin prej 29.12.2018 gjerë më 15.01.2019 dhe në fund do të kryhet barazimi me gjendjen e kontabilitetit dhe raporti do të i dorëzohet komisionit qendror. Komisioni qendror është i obliguar të përpilojë raport mbi kryerjen e të njëjtës dhe t'ia dorëzojë Kryeshefit Ekzekutiv gjerë më 20.01.2019.
- Në bazë të nenit 7. pika 2. Statutit të K. R. U "Hidroregjioni Jugor" Sh.A me seli në Prizren, në këtë tremujor janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve këto rregullore të Kompanisë:
 - a. ***Udhëzuesin për menaxhimin e borxheve në sektorin e shërbimeve të ujit me politikën dhe procedurat për menaxhimin e borxheve të KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh.A Prizren.***
 - b. ***Planin afatgjatë të investimeve për 2019-2028" në KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren.***
- Nga udhëheqësit e departamenteve dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të shërbimeve përkatëse të Kompanisë është bërë vlerësimi vjetor i performancës së secilit punonjës për kryerjen e detyrave të punës në Kompani gjatë viti 2018.
- Gjate këtyre tre muajve ka pas ndërrim të pozitës së punës të punëtorëve brenda Kompanisë dhe sipas pozitës së punës edhe ndryshim koeficienti.
- Janë vazhduar kontratat të punës së punëtorëve të Kompanisë të cilët kanë qene ne afat për gjashtë muaj dhe një vit, dhe të punëtorëve që ka qene kontrata e pare e punës me mundësi të vazhdimit. Me vlerësimin e bere nga ana e udhëheqësve të sektorëve përkatëse janë vazhduar kontratat.
- ***Gjate këtyre tre muajve janë shpallur katër konkurse prej tyre një është Rishpallje:***

- Rishpallje Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit - 10.10.2018.
- Porto/arkëtar ne njësinë punuese Prizren – 30.11.2018.
- Operator te rrjetit dhe kanalizimit ne njësinë punuese Prizren – 04.12.2018.
- Punëtor/e ndihmese ne operativ ne njësinë punuese Prizren – 04.12.2018.
- **Gjate këtyre tre muajve kanë filluar pune 4 (katër) punëtor:**
 - Ne muajin Tetor tre punëtor, prej tyre dy Inkasant me gjysme orari ne njësinë punuese Prizren, dhe një Inspektor/kontrollor orar te plote ne njësinë punuese Malisheve .
 - Ne muajin Dhjetor ka filluar Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit ne K.R.U “ Hidroregjioni jugor” Sh. A – Prizren .
- Nga muaji Dhjetor janë angazhuar me kontratë në kohë të caktuar praktikant në punë praktike ashtu siç është paraparë ne Marrëveshjen e bashkëpunimit për praktikë në punë të punëkërkesve në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenës Sociale dhe KRU”Hidroregjioni Jugor”. Kjo marrëveshje ka filluar të zbatohet nga data 03 dhjetor dhe do të zgjasë deri me 03 Qershor 2019. MPMS punëtorët e angazhuar do të paguaj me pagë mujore në shumën prej 250 euro në muaj dhe KRU”HRJ”do të bashkë financoi projektin duke siguruar mjetet e punës për punëtor si dhe shujtat ditore në vlerë prej 2.5 euro në ditë.
- Në Departament të Administratës kemi pasur auditim nga Zyra Kombëtare e Auditimit, I për periudhën kohore janar-dhjetor 2018.
- Është dërguar prapë kërkesa për riorganizim të NP- KRU”Hidroregjioni Jugor” Sh. A në Prizren dhe KRU” Gjakova”Sh. A në Gjakovë dhe është drejtuar ne MZHE dhe MMPH ende nuk kemi përgjigje nga Ministritë në fjalë.
- Është raportuar në NJPMNP numri i punonjësve të Kompanisë me aftësi të kufizuar për vitin 2017.
- Pas inicimit të procedurës disiplinore ndaj punonjësit Rojtar-kujdestar në stacionin e pompave në Banjë në njësinë e Malishevës M. Sh, për shkak të shkeljeve të detyrave të punës të parapara në nenin 5 të Rregullores së Kompanisë i është shqiptuar masa disiplinore Vërejtje me shkrim.
- Pjesëmarrje në punëtorinë për Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, punëtoria është organizuar nga Agjencia kundër korrupsionit për Ndërmarrjet Publike. Qëllimi parësor i këtij Ligji është forcimi i integritetit të sektorit publik dhe garantimi i kryerjes së detyrave publike në meny objektive,të paanshme dhe transparente.

Raport i numrit të punëtorëve Tetor - Dhjetor, 2018

Nr.	Muaji	Hidroregjioni Jugor	Prizren				Suharekë	Dragash	Malishevë
			Prizren	Bordi	Prakt.	Total			
1.	Tetor	329	234	6		240	37	16	36
2.	Nëntor	329	234	6		240	37	16	36
3.	Dhjetor	330	235	6		241	37	16	36

PERSONELI – TETOR– DHJETOR 2018

Muajt	Nr.i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuara	Te larguar	Të pensionuar	Verejtje
Tetor	323				
Nëntor	323				
Dhjetor	324	1			

NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: DHJETOR- 2018

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Mysliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	279	33	5	7	324
Numri i Punëtorëve në %	86.1	10.2	1.5	2.2	100

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	40	12.35	
MESHKUJ:	284	87.65	
TOTAL	324	100.00	

KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: DHJETOR 2018

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A								
DHJETOR	KUALIFIKIMI							
	Fakultet	Bachelor	Sk.K. e lartë	Sh. e mesme	Sh.N.E	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsej
Nr. i punëtorëve	33	38	1	205		46	1	324
Kualifikimi në %	10.19	11.73	0.31	63.27	0.00	14.20	0.31	100

**PËRFAQËSIMI NË GJYKATA DHE ARDHJA TOTALE E LËNDËVE NGA GJYKATAT PËR PERIUdhËN
KOHORE TETOR – DHJETOR 2018 SEANCAT GJYQËSORE**

Muaji	Seanca përgatit ore	Seanca kryesore	Seanca të shtyra	Totali i seancave gjyqësore	Shkresat e ardhura nga gjykatat
Tetor	2	2	/	4	9
Nëntor	5	/	/	5	109
Dhjetor	3	/	/	3	70
Totali	10	2	/	12	188

Siç edhe shihet në tabelën lart, në këtë periudhë kohore kemi marrë pjesë në gjithsej **12 (dymbëdhjetë)** seanca gjyqësore, prej të cilave **10 (dhjetë)** seanca kanë qenë përgatitore, dhe **2 (dy)** seanca përgatitore.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2018, në Zyrën Ligjore nga Gjykatat kanë ardhur këto shkresa:

- **1 (një)** Aktgjykime në favor të Kompanisë;
- **1 (një)** Aktgjykime kundër Kompanisë;
- **Për 8 (tetë)** lëndë nga gjykatat janë marrë Aktvendime në favor të kompanisë;
- **Për 7 (shtatë)** lëndë nga gjykatat janë marrë Aktvendime kundër kompanisë;
- **Për 17 (shtatëmbëdhjetë)** lëndë gjykatat kanë aprovuar pjesërisht Prapësimet e konsumatorëve;
- **Nuk ka pasur** Konkluzione me të cilat gjykata na njofton se pala në procedurë ka vdekur;
- **7 (shtatë)** Konkluzione me të cilat gjykata cakton përfaqësues të përkohshëm;
- **20 (njëzet)** Konkluzione për njoftim të gjykatës nga ana e kompanisë;
- **Nuk ka pasur** Njoftime nga Gjykata dhe institucione tjera;
- **7 (shtatë)** Thirrje për seanca gjyqësore;
- **Nuk ka pasur** Padi kundër Kompanisë sonë;
- **Nuk ka pasur** Përgjigje në Padi nga Kompania jonë;
- **10 (dhjetë)** Ankesa në Gjykatën e Apelit i kanë parashtruar konsumatorët kundër Vendimeve të gjykatave;

- Nuk ka pasur përgjigje në Ankesat e konsumatorëve pasi që Ankesat kishin të bënin me Vendim të Gjykatës;
- **Nuk ka pasur** Ekspertizë në favor të Kompanisë;
- **Nuk ka pasur** Ekspertizë në dëm të Kompanisë;
- **Nuk ka pasur** Ujdi gjyqësore;
- **Nuk ka pasur** kallëzime penale;
- **1 (një)** Korrigjim të Aktvendimit;
- **Nuk ka pasur** Aktvendim sipas të cilit urdhërohen debitorët;
- **18 (tetëmbëdhjetë)** Aktvendime të hedhura poshtë si jo të plota;

Punët tjera nga Zyra Ligjore

Konsultimin, analizimin dhe studimin e Projektligjeve, Ligjeve të vjetra dhe atyre të reja, Udhëzimeve Administrative, Rregulloreve dhe materialeve tjera lidhur me përgatitjet teorike për nxjerrjen e Rregulloreve të ardhshme të cilat duhet të harmonizohen me Ligjet dhe Aktet tjera të reja;

Pjesëmarrje në Komisionin Disiplinorë ku gjatë këtij tremujori janë mbajtur 3 (tri) seanca, me ç`rast i kemi përgatitur Procesverbalet, Konkluzionet lidhur me shkeljet e bëra nga punonjësit dhe rekomandimet për masën disiplinore ndaj të njëjtëve, si dhe Vendimet lidhur me përgjegjësinë e punonjësve sipas Rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të Kompanisë;

Përgjigje në Ankesa, Përgjigje në Padi, përgjigje dhe udhëzime për konsumatorë, përgjigje ndaj personave tjerë fizik për çështje të ndryshme;

Pjesëmarrje në Komisione për pranimin e punëtorëve në punë, dhe komisione tjera brenda Kompanisë;

Kontakte të vazhdueshme me Përmbaruesit Privat edhe pse jo në masën e nevojshme, sidomos me Përmbaruesin nga Malisheva dhe Suhareka, sepse ende mbetet i pazgjidhur problemi për transport lidhur me punët të cilat duhet ti kryejnë punonjësit e zyrës ligjore.

**PUNËT E KRYERA ME PËRMBARUESIT PRIVAT
TETOR – DHJETOR 2018 NJËSIA PUNUESE PRIZREN**

	Propozime për përbarime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Të përfunduar
Tetor	55	4	4	30	5	5
Nëntor	40	6	5	26	2	4
Dhjetor	51	10	10	11	2	5
Totali	146	20	19	67	9	14

Nga Njësia Punuese e Prizrenit me Përmbarduesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë i kemi dërguar **146 (njëqindtë e dyzet e gjashtë)** lëndë me propozim për përbarim.
- Nga konsumatorët janë parashtruar **20 (njëzetë)** prapësime.
- Nga kompania janë dhënë **19 (nëntëmbëdhjetë)** përgjigje në prapësime.
- Janë lidhur **67 (gjashtëdhjetë e shtatë)** marrëveshje me debitorë.
- **9 (nëntë)** lëndë e tërhequr.
- Janë përfunduar **14 (katërmëdhjetë)** lëndë.

TETOR – DHJETOR 2018 NJËSIA PUNUESE MALISHEVË

	Propozime për përbarime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Të përfunduara
Tetor	15	1	1	8	/	8
Nëntor	/	/	/	4	/	6
Dhjetor	/	/	/	6	/	2
Totali	15	1	1	18	/	16

Nga Njësia Punuese e Malishevës me Përmbarduesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë gjykatë i kemi dërguar **15 (pesëmbëdhjetë)** lëndë me propozim për përbarim.
- Nga konsumatorët është parashtruar **1 (një)** prapësim.
- Nga kompania është bërë **1 (një)** përgjigje në prapësim.
- Janë lidhur **18 (tetëmbëdhjetë)** marrëveshje me debitorë.
- Nuk ka pasur tërheqje lëndësh.
- Janë përfunduar **16 (gjashtëmbëdhjetë)** lëndë.

TETOR – DHJETOR 2018 NJËSIA PUNUESE SUHAREKË

	Propozime për përbarime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Të përfunduara
Tetor	15	1	1	3	1	3
Nëntor	/	/	/	6	/	1
Dhjetor	/	/	/	3	/	3
Totali	15	1	1	12	1	7

Nga Njësia Punuese e Suharekës me Përmbauesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë Gjykatë i kemi dërguar **15 (pesëmbëdhjetë)** lëndë me propozim për përbarim.
- Nga konsumatorët është parashtruar **1 (një)** prapësim.
- Nga kompania është dhënë **1 (një)** përgjigje në prapësim.
- Janë lidhur **12 (dymbëdhjetë)** marrëveshje me debitorë.
- **1 (një)** lëndë është tërhequr.
- Janë përfunduar **7 (shtatë)** lëndë.

TETOR – DHJETOR 2018 NJËSIA PUNUESE DRAGASH

	Propozime për përbarime	Prapësime	Përgjigje në prapësime	Marrëveshje	Tërheqje	Të përfunduara
Tetor	/	1	1	1	/	1
Nëntor	/	1	1	2	1	1
Dhjetor	/	/	/	1	/	/
Totali	/	2	2	4	1	2

Nga Njësia Punuese e Dragashit me Përmbauesit Privat janë kryer këto punë:

- Në këtë gjykatë, **Nuk ka pasur** propozime për përbarim.
- Nga konsumatorët janë parashtruar **2 (dy)** prapësime.
- Nga kompania janë dhënë **2 (dy)** përgjigje në prapësime.
- Janë lidhur **4 (katër)** marrëveshje me debitorë.
- **1 (një)** tërheqje lënde.
- Janë përfunduar **2 (dy)** lëndë.

LËNDËT TË CILAT JANË NË PROCEDURA GJYQËSORE DHE TË CILAT E KËRCËNOJNË KOMPANINË

Nr.	C.nr.	Kontesti	Vlera	Vërejtje
1.	C.nr. 1214/12, datë 05.03.2013	Padi – Kontest nga marrëdhë-nia e punës	Ende e pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë
2.	C. nr. 116/03, datë 08.05.2013	Padi për kompensim dëmi	Dëmshpërblimi ende i pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë
3.	C.nr. 286/14, datë 03.06.2015	Padi – Kontest nga marrëdhë-nia e punës	Dëmshpërblimi ende i pacaktuar	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë
4.	A.nr. 420/2015, datë 03.04.2017	Padi – Kontest lidhur me borxhin e ujit	Kontest administrativ	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prishtinë
5.	C.nr. 170/18, datë 14.09.2018	Padi – kompensim dëmi	Vlera e kontestit 1,170.00 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
6.	C.nr. 471/2017, datë 06.10.2017	Padi – kompensim dëmi	Vlera e kontestit 3200.00 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
7.	C.nr. 416/18, datë 24.05.2018	Padi – Kontest pronësor	Vlera e kontestit 500 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
8.	C.nr. 99/16, datë 06.03.2018	Padi – Kontest pronësorë	Vlera e kontestit 10,000 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Dragash
9.	C.nr. 364/16, datë 12.10.2016	Padi – Kontest pronësorë	Vlera e kontestit 3200 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë
10.	C.nr.1173/18, datë 10.09.2018	Padi – Kontest nga marrëdhë-nia e punës	Vlera e kontestit 3500 €	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren

Aktivitetet e Zyrtarit për Siguri dhe Shëndetin në Punë për TM-4/2018

- Në TM/4 janë realizuar vizitat e objekteve të Kompanisë lidhur me mirëmbajtjen dhe gjendjen tyre, siç janë objekti i “Rezervari i shpatit”, “Filtrat”, “Kuagulatorët”, objektet e “Mulliri i vjetër”, objektet e “40 Burimeve –I”, objekti dhe “40 Burimeve - II” ku janë kontrolluar gjendja e tyre, pastërtia dhe mirëmbajtja e objekteve si dhe hapësira për rreth objekteve.
- Në këtë tremujor përmes firmës kontraktuese “SAP-Internacional sh.p.k” në Prizren kemi bërë servisimin e aparateve kundër zjarrit nëpër të gjitha njësitë punuese sipas dokumentacionit të pranimit- dorëzimit për 70. aparate. Furnizim me aparate kundër zjarrit me CO² që do të përdoret për trafo e rrymës, si dhe furnizimi me 20 aparate 2 kg. që do të përdoren për automjete e kompanisë mirëpo për shkak të transportit të jashtëm ka ngecje në furnizim nga firma kontraktuese.
- Gjatë TM/4 të gjithë punëtorët rojtarë janë furnizuar me uniforma të punës .
- Gjatë TM/4 janë bërë kontrollimi i punëtorëve të shërbimit operativ për kujdesin në punë dhe respektimin e Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, duke realizuar punime në eliminimin e defekteve në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit nëpër disa vende në qytetin e Prizrenit.

Aktivitetet e Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës për TM/4, 2018 - Prizren

Gjatë këtij tremujori janë realizuar vizita/kontrolle të vazhdueshme brenda dhe jashtë orarit në kohë të pacaktuar nëpër të gjitha objektet të cilat sigurohen nga kujdestaret – roje 24 h në pikat e Prizrenit:

- **40 BURIMET**
- **MULLIRI I VJETËR**
- **SHPATI**
- **BUNARI 1**
- **DREJTORIA**
- **KOAGULATORET**
- **FILTRAT**

Si çdo herë në bashkëpunim të ngushtë me Rojet në të gjitha pikat ku ata veprojnë edhe gjatë kësaj periudhe kohore jemi përkujdesur me seriozitet shumë të madh ndaj çdo gjëje dhe pikë që jemi të ngarkuar për ta siguruar.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe kohore të gjitha objektet të cilat kujdestarohen gjatë 24 h në njësinë e Prizrenit, janë furnizuar me pajisje higjienike dhe janë vendosur ndriçues nëpër objektet ku ka pasur nevojë për ndriçim,

Në vazhdimësi janë kryer vizita në të gjitha objektet e njësive punuese dhe për gjendjen e tyre janë njoftuar me shënim zyrtar udhëheqësit e shërbimeve përkatëse të kompanisë.

Raport rreth punës së zyrës së teknologjisë informative për tetor – dhjetor 2016

Asistencë profesionale për funksionimin normal dhe optimal të rrjetit kompjuterik në bazë dhe në njësi të kompanisë.

Ndërhyrje në njësinë e Malishevës (print, server, vpn router, klient) : 56 herë.

Ndërhyrje në Komune – Malisheve: 35 here

Ndërhyrje në njësinë e Therandës (print, server, vpn router, klient) : 83 herë.

Ndërhyrje në Komune – Suhareke: 47 here.

Ndërhyrje në njësinë e Dragashit (print, server, vpn router, klientë): 32 herë.

Ndërhyrje në njesitë Shatërvan: 51 herë.

Ndërhyrje në njesitë Depo: 25 herë.

Ndërhyrje në njesinë Filtrat: 75 herë.

Ndërhyrje në Komunë - Prizren: 107 herë.

Ndërhyrje në Ueb Faqe 30 herë; Njoftime për konsumatore, gjithsejt 18, ngarkim i dokumenteve (konkurseve) 12.

Ndërhyrje në Bazë (print, server, vpn router, klientë, fotokopje) : 872 herë.

Përkujdesje për qasjen e Kompanisë në rrjetin e internetit.

Përkujdesje për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës së serverit qendror, programit NAVISION, serverave të Njësive, serverit të GIS sistemit dhe sigurisë së të dhënave.

Asistencë teknike për funksionimin normal të rrjetit telefonik lokal dhe fiks.

Planifikim i infrastrukturës së mëtutjeshme në bazë të nevojave dhe kërkesave të Kompanisë.

Riparim harvderik dhe softuerik të pajisjeve kompjuterike, programeve aplikative operacionale që shfrytëzohen në Kompani.

Mbikëqyrje rreth zbatimit të kontratave të furnizimeve dhe servisimeve të pajisjeve kompjuterike e pajisjeve të ngjashme teknike.

Përkujdesje për licencimin - vazhdimin e licencimit të programeve operative të kompanisë.

Përditësim i ueb faqes së Kompanisë.

Rregullim rrjeti ne Filtra, (Problem me IPKO).

Rregullim i Fotokopjes 5655 ne Prizren nga MIRI XEROX

Perkujdesje per mbarevajtjen e shtypjes se faturave.

Perkujdesje ditore në ruajtjen e shënimeve të serverëve. Serveri Databaze, GIS, DNS.

Perkujdesje per garancionet e paisjeve dhe dergimin e paisjeve te amortizuara per asgjesim ne Depo.

Perkujdesje ne hapjen e perdoruesve te rinje ne Baze dhe Njesi.

Perkujdesje per shenimin dhe organizimin e furnizimit te paisjeve nga furnitori

Konfigurim i modemit te postes.

Dorezim i laptopeve te vjeter, gjithsejt 4; Liridon Bajraktari, Bujar Spahiu, Aranit Ukimeri, Zenel Zenelaj, Fadil Kurtaj, Fadil Berisha.

Ndihme ne shtypjen e faturave ne Baze dhe njesi.

Rregullim rrjeti ne Filtra, nderrim i modemit.

Rregullim i shtypjes se verejtjeve ne zyren e shefit te inkasanteve.

Hapje e perdoruesve te rinje ne NAV dhe Billing.

Krijim i PPTP Usereve per kyqjen nga larg.

Marrje e pjeseve funksionale nga Kompjuteret e vjeter (te djegur ne pllake), e qe ishin te pa aftesueshem dhe pjeset e vjetra i kemi dergu per ç' regjistrim ne Depo. Ketu kemi perfshire (Printer, Kompjuteret, Ups).

Marrje e 6 PC te rinje Acer (6), Lenovo (2) ne nevoja te Kompanise.

PROBLEMET GJATË PROCESIT TË PUNËS

Vazhdojnë te jen problem lëndët e lartcekura të cilat e kërcënojnë Kompaninë ku tri lëndë kanë bëjnë me kontest nga marrëdhënia e punës ndërsa njëra me kompensim dëmi, kontest pronësor dhe kontest lidhur me borxhin e ujit.

Gjatë procesit të punës Zyra Ligjore ballafaqohet me probleme të natyrave të ndryshme, ndër të cilat mundë ti përmendim:

Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, respektivisht Neni 360, Paragrafi 1, Nënparagrafi 1.1, e parasheh afatin njëvjeçarë të parashkrimit për ujë të pijes, me ç`rast kompanisë po i shkakton dëme të konsiderueshme materiale, pasi që gjykata në shumicën e Vendimeve të cilat po i merr po thirret pikërisht në këtë dispozitë, ndërsa kompania për këto borxhe ka qenë e ngarkuar dhe ka paguar TVSH.

Deri te përbarimi i lëndës përbaruesi has në probleme të ndryshme duke filluar nga gabimet në evidentimin e konsumatorëve, ku në propozim për përbarim figuron emër tjetër, ndërsa shfrytëzues i shërbimeve të ujit është person krejt tjetër.

Mungesa e numrave personal gjithashtu ndikon në vonesa për përbarimin e lëndëve.

Pasaktësia e adresave të vendbanimit të konsumatorëve gjithashtu ndikon në vonesa për përbarimin e lëndëve.

Faturimi në emra të vdekurve, sjellë humbje kohe dhe probleme tjera përcjellëse, pasi që të njëjtëve duhet të ju caktohen përfaqësues të përkohshëm.

Kyçjet ilegale të konsumatorëve për kompaninë janë të kushtueshme, mirëpo Vendimet e gjykatave në aspektin e disiplinimit të konsumatorëve kanë dhënë rezultate pozitive edhe pse ato ende janë rezultate fillestare.

Rastet sociale të konsumatorëve gjithashtu na paraqesin problem, sepse neve jemi të detyruar që ti tërheqim propozimet për përbarim kur bëhet fjalë për rastet e rënda sociale, e që shpenzimet për taksat e përbarimit bien mbi kompaninë.

Probleme na paraqesin edhe rastet kur edhe pse konsumatori është shkyçur, faturimi vazhdon, dhe me këtë dëmtohet konsumatori por edhe kompania, sepse ne ngarkohemi me TVSH dhe njëkohësisht me veprime të tilla dëmtohet edhe imazhi i kompanisë.

Propozim për zgjidhjen e problemeve

Sipas Zyrës Ligjore për tu zgjidhur problemet e lartcekura, nevojitet angazhim i të gjithë punonjësve dhe në veçanti angazhimi i Inkasantëve pasi që janë në kontakte të rregullta me konsumatorët, ku faktori kryesor përgjegjës për ti ikur parashkrimit të borxheve ndaj kompanisë do të ishte që të njëjtët të detyrohen që të inkasojnë të paktën një pagesë nga borxhi i krijuar brenda vitit kalendarik nga konsumatori, ndërsa sa i përket eliminimit të problemit lidhur me konsumatorët e vdekur, ne propozojmë se zgjidhja më e mirë do të ishte shkyçja nga rrjeti i ujësjellësit nëse pasardhësi nuk pranon të kalojë borxhi në emër të tij.

PUNËT E REALIZUARA NGA TM PARAPRAK

Vlerësoj se Departamenti Administrativ ka bërë një përmbyllje të kënaqshme të TM4-2018, janë realizuar të gjitha obligimet ligjore të parapara në detyrat e punës si përgjegjësi kryesore dhe në statutin e Kompanisë.

Janë respektuar Politikat e Kompanisë për Procedimin për Përmbartim të Borxheve të Konsumatorëve të cilët nuk i paguajnë faturat e tyre ndaj Kompanisë për shërbimet e ofruara , për Arkëtimin e të gjitha faturave të pakontestueshme për shërbimet e ofruara.

SYNIMET E DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

Synim i Departamentit Administrativ është përcjellja dhe zbatimi i të gjitha ligjeve dhe ndryshimeve eventuale që kanë të bëjnë me funksionalizimin sa më të mirë të kompanisë.

Mbetet që në vazhdimësi të punohet në Përpilimin e rregulloreve të nevojshme, për rregullimin e politikave dhe procedurave të përgjithshme të KRU”Hidroregjioni Jugor”Sh. A, duke u bazuar në nevojën për suksesin e mbarëvajtjeve të punëve në Kompani si dhe propozimeve të dala nga Menaxhmenti ,Bordi I Drejtorëve dhe Aksionari-Qeveria e Republikës së Kosovës.

Përfaqësim sa më të mirë në Gjykatë dhe Institucionet kudo që do të paraqitet nevoja;

Të vazhdojmë me nxjerrjen e Akteve të reja, korrigjimet, eventuale të Akteve ekzistuese ku vërejmë se ka vend për intervenime, pastaj të bëjmë ndryshime dhe plotësime të Akteve të brendshme të Kompanisë sipas kërkesave Ligjore.

V. RAPORT I AUDITORIT TË BRENDSTEM

Përmes këtij raporti, është bërë përmbledhja dhe prezentimi i punëve dhe aktiviteteve të auditorit të brendshëm, të realizuara gjatë periudhës kohore tetor - dhjetor 2018.

Në pajtim me planin vjetor të punës, si dhe bazuar në kërkesat e komisionit të auditimit, gjatë kësaj periudhe tremujore janë realizuar disa auditime, sikurse janë:

- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të prokurimit,
- Auditimi lidhur me menaxhimin e proceseve në Njësinë Punuese në Suharekë,
- Auditimi lidhur me menaxhimin e proceseve në Njësinë Punuese në Malishevë,
- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të përgatitjes dhe realizimit të Plan biznesit të kompanisë për vitin 2018,
- Auditimi lidhur me menaxhimin e proceseve në Njësinë Punuese në Dragash,
- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të furnizimit – logjistikës,
- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të dhënies së pëlqimeve dhe lejeve për kyçje.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është përgatitur:

- Plani strategjik i punës së auditimit të brendshëm, për periudhën 2019-2021,
- Plani vjetor i aktiviteteve të auditimit të brendshëm për periudhën 2019, si dhe
- Statuti i aktiviteteve të auditimit të brendshëm.

Pas përfundimit të auditimeve, në pajtim me procedurat e punës dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm është punuar në:

- përgatitjen e drafraporteve të auditimit,
- mbajtjen e takimeve përmbyllëse me menaxhmentin – subjektet e audituara,
- diskutimin e të gjeturave dhe rekomandimeve, si dhe është bërë
- përgatitja e drafteve dhe raporteve finale.

Bazuar në konstatimet dhe të gjeturat e auditimeve të këtij tremujori, është konstatuar se në përgjithësi menaxhimi i proceseve dhe zhvillimi i procedurave, është kryer në:

- pajtim me dispozitat ligjore dhe aktet tjera të brendshme,
- është treguar një performancë e mirë e shërbimeve, si dhe
- është konstatuar një funksionim i mirë i kontrollit të brendshëm.

Në disa procese janë konstatuar edhe mangësi, ku dhe është rekomanduar që ato të përmirësohen, andaj edhe pritet që të realizohen gjatë muajve në vazhdim.

(Raportet lidhur me aktivitetet në fjalë, në kopje fizike i janë bashkangjitur raportit tremujor).

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe tremujore, është vepruar në:

- rishikimin e adresimit të rekomandimeve të dhëna gjatë TM3/2018, si dhe
- angazhimi në ofrimin dhe përgatitjen e dokumentacionit, lidhur fazën e ndërmjetme të auditimit të pasqyrave financiare 2018, nga ana e Zyres Kombëtare të Auditimit.

Adresimet e rekomandimeve të periudhës tremujore paraprahe TM3/2018

Në mënyrë që të jipet një pasqyrë e adresimeve të rekomandimeve të tremujorit të tretë (TM3), në mënyrë kronologjike, janë prezentuar konstatimet, të gjeturat, konkluzionet, rekomandimet, komentet dhe adresimi i tyre.

- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të tatimeve të pagueshme;
- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të faturimit dhe inkasimit në shërbimin e inkasantëve në Nj.P në Prizren, si dhe
- Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të pagave të punëtorëve të shërbimit të operativës së Nj.P në Prizren

Rezultatet - Konstatimet, të gjeturat, konkluzionet, rekomandimet, komentet e menaxhmentit dhe adresimi i rekomandimeve.

1. Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të tatimeve të pagueshme

Gjatë auditimit të kryer në departamentin e financave – në shërbimin e kontabilitetit, lidhur me menaxhimin e procesit të tatimeve të pagueshme, gjeëgjësisht obligimeve për tatime dhe kontribute, është konstatuar se regjistrimi dhe prezentimi i kësaj kategorie në pasqyrat financiare të vitit 2017, është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, konkretisht në pajtim me SNK nr.1, paragrafi 60, i cili obligon mënyrën e paraqitjes së të pagueshmeve në pasqyrat financiare, të strukturuar në detyrime afatgjata dhe SNK nr.12.

Ndërsa sipas SNK 12, paragrafi 12, 46 dhe 47, kërkohet se si të bëhet trajtimi i Tatimeve mbi të Ardhurat, njohja e detyrimeve të tatimeve aktuale dhe pasurive të tatimeve aktuale.

Është konstatuar se gjendja e obligimeve tatimore për vitin 2017, të prezentuara në pasqyrat financiare është në shumë prej 1,817,695.50 euro, ku prej tyre: pagat e pagueshme janë 7,807.76 euro, tatimet (TVSH) e pagueshme 1,794,216.44 euro, kontributet pensionale 15,671.30 euro, si dhe totali i obligimeve ndaj punëtorëve - BSPK - 8,186.08 euro.

E gjetura: Edhe përkundër një procesi të menaxhuar mirë, megjithatë pozicioni lidhur me obligimet ndaj të punësuarëve (në emër të sindikatës - BSPK) që prezantohet në shumë prej 8,186.08 euro, bazuar në dokumentacionin e ofruar nuk ka një sqarim adekuat dhe historik të mirëfilltë. Shuma në fjalë në dokumentacion kontabël figuron e njëjtë që nga viti 2008, si dhe për atë fond edhe pse janë kalkuluar mjete nga fondi i pagave, megjithatë mjetet në fjalë nuk janë në ndonjë llogari bankare.

Konkluzion: Edhe pse sipas zyrtarëve të shërbimit financiar, ekzekutimi i shumës së caktuar është kryer në marrëveshje me punëtorët, mirëpo meqë për këtë mungon një informacion i duhur, konsideroj se tregon për një funksionim jo të mirë të kontrollit të brendshëm dhe për një devijim të mundshëm të procesit.

Rekomandim: Rekomandohet menaxheri financiar, që në bashkëpunim me menaxhmentin e lartë, si dhe zyrtarë tjerë të kyçur më parë në këtë proces, të bëjnë identifikimin dhe sqarimin e pozicionit të obligimeve në emër të pagesës në fondin e sindikatës së kompanisë.

Komentet e menaxhmentit: Rekomandimi pranohet. Në bashkëpunim me menaxhmentin e lartë jemi përpjekur të kontaktojmë me personin e autorizuar në këtë llogari, si dhe do të angazhohemi në sqarimin dhe definimin e çështjes në fjalë.

Rekomandimi ende nuk është implementuar, edhe përkundër përpjekjeve të menaxhmentit lidhur me sigurimin e të dhënave për rastin në fjalë, rast ky i cili i takon periudhës kohore 2000–2008.

2. Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të faturimit dhe inkasimit

në shërbimin e inkasantëve në Nj.P në Prizren

Gjatë rishikimit dhe testimit të dokumentacionit lidhur me procesin e faturimit dhe të inkasimit, në shërbimin e inkasantëve të Njësisë së Prizrenit, për periudhën janar – korrik 2018, është konstatuar se në përgjithësi procesi është menaxhuar mirë dhe është në pajtim me vendimet e brendshme të kompanisë. Poashtu është konstatuar se në përjashtim të disa rasteve, marrë në tërësi, realizimi muajor përmes shërbimit të inkasantëve ka qenë i një performace të kënaqshme.

E gjetura: Gjatë auditimit të të dhënave të faturimit, të realizuara përmes inkasantëve, edhe pse vërehet një trend rritës i faturimit, megjithatë është konstatuar një mangësi, e që ka të bëjë me atë se një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve, janë duke u faturuar me tarifë fikse.

Është konstatuar se gjatë muajit korrik nga gjithsej 33,010 konsumatorë sa faturohen përmes 35 inkasantëve, prej tyre 9,232 konsumatorë apo 27,97%, faturohen me këtë tarifë. Numri më i lartë i konsumatorëve të faturuar me tarifë fikse, është tek konsumatorët shtëpiak me një pjesëmarrje prej rreth 85%.

Gjithashtu është konstatuar se mesatarja e faturimit ndryshon tek inkasantët, nga më e ulta te inkasanti nr.19 ku përqindja gjatë muajit korrik është 15.7%, ndërsa 50.31% tek inkasanti nr.8.

Konkluzion: Faturimi i konsumatorëve me tarifë fikse, sipas përqindjes së prezentuar, tregon për një proces që ka nevojë për tu përmirësuar, dhe që do të ndikonte drejtëpërdrejt në rritjen e faturimit dhe në performancën e kompanisë.

Rekomandim: Rekomandohet menaxheri regional me konsumatorë, që në bashkëpunim me shefin e shërbimit të inkasantëve, të analizoj dhe shqyrtoj gjendjen e konstatuar të faturimit të konsumatorëve me tarifë fikse, si dhe të mirren veprime të duhura në përmirësimin e procesit.

Komentet e menaxhmentit: Rekomandimi është pranuar. Është ritheksuar se faturimi me tarifë fikse është rezultat i konsumatorëve të cilët i kanë objektet e mbyllura. Ndërsa për konsumatorët që nuk u funksionon ujëmatësi, mbetet që ky proces të realizohet, në bashkëpunim me ekipin e ndërrimit të ujëmatësve.

Rekomandimi ka filluar të implementohet. Shërbimi me konsumatorë përmes inkasantëve dhe kontrollës, ka bërë identifikimin e konsumatorëve që faturohen me tarifë fikse. Ekzistojnë listat me të dhëna dhe përshkrim të gjendjes në terren. Janë marrë si prioritet konsumatorët e evidentuar që nuk ekzistojnë, dhe pritet që përmes komisioneve gjegjëse të tillët të pasivizohen, ndërsa të tjerët të vazhdojnë të mbesin si konsumatorë.

E gjetura: Gjatë auditimit të faturimit, gjithashtu është vërejtur se një numër i konsiderueshëm i konsumatorëve, mesatarisht rreth 5%, në mungesë të ujëmatësve apo për shkak të defektit të ujëmartësve, nuk faturohen sipas leximit mirëpo në mënyrë paushalle.

Vërejtja qëndron në faktin se, edhe përkundër tarifës për paushall për banesa (15 m³), janë vërejtur raste kur kjo tarifë nuk është respektuar në tërësi, sidomos tek ato banesa ku kanë nga dy ujëmatësa. Gjithashtu për rastet e faturimit me pushall për shtëpi banimi edhe pse është dhënë një afat që në rast të mos vendosjes së ujëmatësve, konsumatorët në fjalë është kërkuar të shkyqen nga rrjeti i ujësjellësit, me ç'rast një gjë e tillë nuk është bërë.

Konkluzion: Faturimi i konsumatorëve me paushall, duke mos e respektuar vendimin e autoritetit, konsideroj se e dëmtojnë procesin e faturimit, sepse mos faturimi përmes paushallit të caktuar nga ARRU, dhe mos veprimi sipas këtij vendimi, ndikon në humbjen e efektit të dëshiruar që konsumatorët të bëjnë vendosjen e ujëmatësve.

Rekomandim: Rekomandohet menaxheri me konsumatorë që në bashkëpunim me vartësit e tij, si dhe në bashkëpunim me departamentin teknik, gjegjësisht ekipin e ndërrimit të ujëmatësve, të

rishikojnë rastin e konsumatorëve të ngarkuar me paushall, të bëjnë vendosjen e ujëmatësve, meqë mënyra e tillë e faturimit është në kundërshtim me udhëzimet dhe rregullat e ARRU-së, gjegjësisht vendimit me nr.170 të datës 02.03.2018, si dhe ndikon në rënien e shumës së faturimit.

Komentet e menaxhmentit: Rekomandimi është pranuar. Gjithashtu është shtuar se faturimi paushall te konsumatorët shtëpiak, është rezultat i mungesës së ujëmatësve, të cilët janë faturuar duke u bazuar në shpenzimin mesatar të konsumatorëve që kanë ujëmatës. Gjithashtu, në përmbushjen e këtij rekomandimi, mbetet të kërkohet edhe angazhimi më i madh i ekipit të ndërrimit të ujëmatësve.

Rekomandimi ka filluar të implementohet. Përmes një kërkesë me shkrim, menaxheri me konsumatorë i është drejtuar shërbimit teknik, që të bëjnë vendosjen e ujëmatësve të konsumatorëve të faturuar me paushall, me çrast në bazë të të dhënave të shërbimit teknik, sipas kapacitetit të ekipeve montuese, kjo ka filluar të bëhet, ku numri i tyre silltet nga 62 deri në 122 ujëmatësa në muaj.

E gjetura: Gjatë auditimit, është bërë edhe testimi dhe vlerësimi i performancës së inkasantëve në baza individuale, me çrast, është vërejtur se në përgjithësi performanca e tyre ka qenë e mirë, me mbulueshmëri të normativit. Mirëpo, një numër i inkasantëve gjatë kësaj periudhe kanë qenë jo performues. Nga numri i përgjithshëm i inkasantëve, duke marrë për bazë bashkimin e terreneve (inkasantit dhe lexuesit), gjatë disa muajve të testuar, mospërmbushje të normës, kanë pasur deri në 51.43% të tyre.

Konkluzion: Edhe përkundër përmirësimit të performancës së inkasantëve gjatë muait korrik, ku vetëm dy prej tyre me diferencë të ultë nuk kanë arritur të realizojnë normën (ink. nr.25 dhe ai 26), megjithatë konsideroj se përveq që një gjë e tillë, ndikon në dëm të vet inkasantit, meqë ai stimulohet me 5% të normës bazë, e që mendoj se është pak, mirëpo kjo njëherit po ndikon negativisht në performancën e shërbimit të inkasimit.

Rekomandim: Rekomandohet menaxheri i shërbimit për konsumatorë që përmes shefit të inkasantëve, vazhdimisht të marrë masa dhe veprime në përmirësimin e performancës individuale të inkasantëve në pajtim me vendimet dhe aktet e brendshme të kompanisë, gjegjësisht Vendimit mbi përcaktimin e normës për llogaritjen e të ardhurave personale mujore të inkasantëve , me nr.protokoli 1523/1, të datës 29.06.2018.

Komentet e menaxhmentit: Rekomandimi është pranuar. Janë dhënë disa komente shtesë lidhur me mënyrën e trajtimit të inkasantëve performues dhe atyre jo performues, si dhe pamundësinë e mosrealizimit të normës (mungesën e furnizimit të rregullt me ujë) si dhe raste kur për shuma minimale nuk kanë mundur të përmbushin normën.

Rekomandimi është duke u implementuar, megjithatë jo në tërësi. Përkundër angazhimeve, sipas menaxherit me konsumatorë performanca e inkasantëve është pothuaj e njëjtë. Megjithatë gjatë muajve në vijim pritet të ndryshohet edhe mënyra e inkasimit, andaj edhe mbetet, që kjo të rishikohet gjatë vitit në vijim.

E gjetura: Në bazë të testimeve të kryera, ku për bazë është marrë muaji korrik 2018, është konstatuar se numri i konsumatorëve që kanë paguar faturën mujore, në raport me totalin e konsumatorëve, ka qenë i një niveli jo të mirë. Nga totali prej 33,010 konsumatorëve të ndarë sipas 35 inkasantëve, kanë paguar vetëm 13,828, apo 41.89% e tyre.

Kjo përqindje, në baza individuale ndryshon sipas inkasantëve. Tek disa është më e mirë, me mbi 50%, ndërsa tek disa shumë e dobtë nën 30% të konsumatorëve.

Konkluzion: Pjesëmarrja e ultë e numrit të konsumatorëve që realizojnë pagesa, edhe pse është testuar muaji kur bëhen më shumë pagesa gjatë vitit, tregon që në periudhat tjera kjo pjesëmarrje mund të jetë edhe më e ultë, konsideroj se kjo tregon për efikasitetin e ultë në kryerjen e detyrave të punës.

Rekomandim: Rekomandohet menaxheri regional me konsumatorë që në bashkëpunim me shefin e inkasantëve, që përmes kontrolleve dhe masave tjera gjegjëse, të veprojnë dhe të sigurohen se konsumatorët vizitohen nga inkasantët, përpiqen për arkëtimin e pagesës apo borxhit, në të kundërtën mbetet të veprohet në pajtim me vendimet e brendshme.

Komentet e menaxhmentit: Rekomandimi është pranuar, duke theksuar se kjo gjendje ka qenë gjithnjë shqetësim i shërbimit me konsumatorë, andaj do të angazhohemi në përmirësim të tij. Gjithashtu është theksuar se në këtë kategori bëjnë pjesë edhe një numër i konsumatorëve që nuk banojnë rregullisht, e të cilët paguajnë një herë ose dy herë në vjet.

Rekomandimi është duke u implementuar. Megjithatë përkundër angazhimeve, përqindja e pagesave të realizuara ka mbetur pothuaj e njëjtë. Bazuar në të dhënat e muajit nëntor 2018, mesatarja e pagesave të faturës rrjedhëse është rreth 40%.

3. Auditimi lidhur me menaxhimin e procesit të pagave të punëtorëve të shërbimit të operativës së Nj.P në Prizren

Gjatë rishikimit dhe testimit të dokumentacionit lidhur me pagesat e orëve jashtë orarit të punës së punëtorëve të shërbimit të operativës, të Nj.P. Prizren, për periudhën janar – gusht 2018, është konstatuar se në përgjithësi procesi është menaxhuar mirë, pagesat për orët në fjalë në krahasim me numrin e punëtorëve janë të ulta, ka të instaluar një kontrollë të brendshme funksionale, si dhe është vepruar në pajtim me ligjet aplikative.

E gjetura: Është konstatuar se procesi lidhur me caktimin e grupeve të punës, caktimit të grupit jashtë orarit dhe atij të punës së kujdestarisë, nuk ka ndonjë program të rregulluar me ndonjë akt të brendshëm, mirëpo kjo bëhet në bazë të praktikave të mëhershme, sipas rotacionit të grupeve.

Konkluzion: Edhe përkundër faktit se punëtorët dhe menaxhmenti janë përshtatur orareve të punës, megjithatë mungesa e një akti mund të ketë ndikim në kontrollin dhe në dhënien e përgjegjësisë së stafit por edhe të vetë menaxhmentit.

Rekomandim: Rekomandohet menaxheri i Njesisë që në bashkëpunim me zyrën ligjore, të përgatisin një akt të brendshëm ku do të përshkruhet dhe saktësohet, caktimi i orareve dhe grupeve që do të punojnë gjatë ndërrimeve ditore, si dhe i njëjti të përgatitet për një periudhë më të gjatë kohore – disa muajore.

Komentet e menaxhmentit: Rekomandimi pranohet. Në bashkëpunim me menaxherin teknik si dhe shërbimin juridik, gjatë kësaj periudhe të mbetur të vitit 2018, do të përpiqemi të realizojmë rekomandimin e dhënë.

Rekomandimi është implementuar. Ekziston vendimi me shkrim i nxjerrë nga K.E, me nr.protokoli 2840, datë 15.11.2018, si dhe akti tjetër përmes të cilit bëhet caktimi orareve dhe grupeve të punëtorëve të shërbimit të operativës (mostër e testuar e datës 30.11.2018).

V. RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE
TM1-TM2-TM3-TM4-2018

● **NJËSIA PUNUESE - PRIZREN**

MUAJI	TM1-2018	TM2-2018	TM3-2018	TM4-2018	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	2,764,762	3,333,400	3,668,300	3,036,700	(631,600)	-17.22
<i>Faturimi m3</i>	1,234,061	1,446,578	1,587,786	1,384,866	(202,920)	-12.78
<i>Faturimi nga uji €</i>	721,419.35 €	831,873.65 €	895,896.18 €	814,813.31 €	- 81,082.87 €	-9.05
<i>Faturimi- te tjera €</i>	4,869.33 €	11,807.74 €	14,010.36 €	9,911.81 €	- 4,098.55 €	-29.25
<i>Faturimi Total €</i>	726,288.68 €	843,681.39 €	909,906.54 €	824,725.12 €	- 85,181.42 €	-9.36
<i>Inkasimi nga uji €</i>	677,203.84 €	731,640.79 €	894,773.68 €	874,475.24 €	- 20,298.44 €	-2.27
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	3,871.13 €	2,190.84 €	5,189.74 €	5,020.98 €	- 168.76 €	-3.25
<i>Inkasimi Total €</i>	681,074.97 €	733,831.63 €	899,963.42 €	879,496.22 €	- 20,467.20 €	-2.27
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	32,869	33,104	33,657	34,452	795	2.36
<i>% e inkasimit</i>	93.87	87.95	99.87	107.32	7.45	7.46
<i>Shpenzimet</i>	676,165.90 €	647,013.77 €	689,890.77 €	746,901.14 €	57,010.37 €	8.26
<i>Pagat</i>	376,358.10 €	376,365.47 €	397,343.51 €	413,578.73 €	16,235.22 €	4.09
<i>Rryma elektrike</i>	143,581.03 €	140,665.50 €	148,825.45 €	153,528.19 €	4,702.74 €	3.16
<i>Shpe. e derivateveve</i>	15,791.28 €	12,843.87 €	14,343.79 €	22,164.40 €	7,820.61 €	54.52
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	73,398.24 €	42,119.18 €	48,294.78 €	58,603.50 €	10,308.72 €	21.35
<i>Miremb, e automjeteve</i>	7,519.75 €	3,924.59 €	12,327.86 €	13,415.84 €	1,087.98 €	8.83
<i>Shpen. E taksave</i>	15,535.33 €	20,764.01 €	22,197.82 €	22,132.95 €	- 64.87 €	-0.29
<i>Kemikalet</i>	2,560.23 €	2,171.19 €	1,100.00 €	3,760.60 €	2,660.60 €	241.87
<i>Shpenzimet tjera</i>	41,421.94 €	48,159.96 €	45,457.56 €	59,716.93 €	14,259.37 €	31.37
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	1,530,701	1,886,822	2,080,514	1,651,834	(428,680)	-20.60
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	55.36	56.60	56.72	54.40	(2.32)	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.01	1.13	1.30	1.18	(0.13)	
	4,909.07 €	86,817.86 €	210,072.65 €	132,595.08 €	- 77,477.57 €	

RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE
TM1-TM2-TM3-TM4-2018

• NJËSIA PUNUESE - SUHAREKË

MUAJI	TM1-2018	TM2-2018	TM3-2018	TM4-2018	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	474,875	473,186	469,457	499,660	30,203	6.43
<i>Faturimi m3</i>	213,062	223,943	248,399	223,303	(25,096)	-10.10
<i>Faturimi nga uji €</i>	127,200.67 €	131,586.24 €	143,729.30 €	133,338.85 €	- 10,390.45 €	-7.23
<i>Faturimi- te tjera €</i>	2,387.01 €	1,523.83 €	1,171.00 €	1,836.46 €	665.46 €	56.83
<i>Faturimi Total €</i>	129,587.68 €	133,110.07 €	144,900.30 €	135,175.31 €	- 9,724.99 €	-6.71
<i>Inkasimi nga uji €</i>	103,791.33 €	100,209.12 €	134,530.20 €	136,268.99 €	1,738.79 €	1.29
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	887.67 €	2,014.68 €	961.35 €	1,553.30 €	591.95 €	61.57
<i>Inkasimi Total €</i>	104,679.00 €	102,223.80 €	135,491.55 €	137,822.29 €	2,330.74 €	1.72
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	6,921	6,982	7,075	7,180	105	1.48
<i>% e inkasimit</i>	81.60	76.15	93.60	102.20	8.60	9.19
<i>Shpenzimet</i>	96,762.60 €	100,133.01 €	116,175.21 €	114,392.58 €	- 1,782.63 €	-1.53
<i>Pagat</i>	52,624.18 €	51,405.77 €	54,473.65 €	58,149.03 €	3,675.38 €	6.75
<i>Rryma elektrike</i>	32,760.86 €	36,573.55 €	42,894.22 €	33,485.27 €	- 9,408.95 €	-21.94
<i>Shpe. e derivateveve</i>	2,639.69 €	2,473.46 €	2,865.96 €	4,148.34 €	1,282.38 €	44.75
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	2,960.47 €	5,215.47 €	10,014.09 €	10,875.09 €	861.00 €	8.60
<i>Miremb, e automjeteve</i>	1,136.76 €	627.31 €	1,267.43 €	3,126.62 €	1,859.19 €	146.69
<i>Shpen. E taksave</i>	1,504.30 €	694.00 €	638.00 €	663.00 €	25.00 €	3.92
<i>Kemikalet</i>	718.18 €	326.68 €	721.15 €	83.90 €	- 637.25 €	-88.37
<i>Shpenzimet tjera</i>	2,418.16 €	2,816.77 €	3,300.71 €	3,861.33 €	560.62 €	16.98
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	261,813	249,243	221,058	276,357	55,299	25.02
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	55.13	52.67	47.09	55.31	8.22	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.08	1.02	1.17	1.20	0.04	
	7,916.40 €	2,090.79 €	19,316.34 €	23,429.71 €	4,113.37 €	

RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE
TM1-TM2-TM3-TM4-2018

• NJËSIA PUNUESE - MALISHEVË

MUAJI	TM1-2018	TM2-2018	TM3-2018	TM4-2018	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	355,788	356,280	349,762	356,952	7,190	2.06
<i>Faturimi m3</i>	141,425	179,440	167,261	156,480	(10,781)	-6.45
<i>Faturimi nga uji €</i>	91,048.19 €	108,741.11 €	103,071.12 €	99,093.02 €	- 3,978.10 €	-3.86
<i>Faturimi- te tjera €</i>	9,055.76 €	1,750.79 €	2,429.09 €	10,578.19 €	8,149.10 €	335.48
<i>Faturimi Total €</i>	100,103.95 €	110,491.90 €	105,500.21 €	109,671.21 €	4,171.00 €	3.95
<i>Inkasimi nga uji €</i>	79,828.66 €	79,499.60 €	95,909.67 €	111,480.16 €	15,570.49 €	16.23
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	2,776.17 €	9,142.41 €	2,250.70 €	4,929.15 €	2,678.45 €	119.01
<i>Inkasimi Total €</i>	82,604.83 €	88,642.01 €	98,160.37 €	116,409.31 €	18,248.94 €	18.59
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	5,368	5,442	5,440	5,497	57	1.05
<i>% e inkasimit</i>	87.68	73.11	93.05	112.50	19.45	20.90
<i>Shpenzimet</i>	78,110.83 €	83,011.91 €	84,119.20 €	91,285.29 €	7,166.09 €	8.52
<i>Pagat</i>	46,361.89 €	44,671.07 €	46,637.00 €	51,693.35 €	5,056.35 €	10.84
<i>Rryma elektrike</i>	25,479.14 €	29,601.29 €	30,596.13 €	27,934.50 €	- 2,661.63 €	-8.70
<i>Shpe. e derivateveve</i>	1,595.13 €	2,231.93 €	1,743.23 €	2,224.21 €	480.98 €	27.59
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	813.18 €	1,559.54 €	1,855.63 €	4,154.82 €	2,299.19 €	123.90
<i>Miremb, e automjeteve</i>	476.58 €	1,783.47 €	1,170.12 €	1,665.20 €	495.08 €	42.31
<i>Shpen. E taksave</i>	1,439.61 €	546.87 €	567.62 €	609.87 €	42.25 €	7.44
<i>Kemikalet</i>	252.80 €	225.26 €	362.73 €	266.91 €	- 95.82 €	-26.42
<i>Shpenzimet tjera</i>	1,692.50 €	2,392.48 €	1,186.74 €	2,736.43 €	1,549.69 €	130.58
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	214,363	176,840	182,501	200,472	17,971	9.85
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	60.25	49.64	52.18	56.16	3.98	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.06	1.07	1.17	1.28	0.11	
	4,494.00 €	5,630.10 €	14,041.17 €	25,124.02 €	11,082.85 €	

RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE
TM1-TM2-TM3-TM4-2018

● **NJËSIA PUNUESE - DRAGASH**

MUAJI	TM1-2018	TM2-2018	TM3-2018	TM4-2018	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	181,195	238,463	249,583	229,929	(19,654)	-7.87
<i>Faturimi m3</i>	29,185	38,328	43,765	31,999	(11,766)	-26.88
<i>Faturimi nga uji €</i>	20,402.94 €	23,922.63 €	27,107.36 €	21,069.91 €	- 6,037.45 €	-22.27
<i>Faturimi- te tjera €</i>	43.00 €	947.95 €	100.02 €	131.00 €	30.98 €	30.97
<i>Faturimi Total €</i>	20,445.94 €	24,870.58 €	27,207.38 €	21,200.91 €	- 6,006.47 €	-22.08
<i>Inkasimi nga uji €</i>	18,842.45 €	20,376.52 €	26,663.47 €	24,141.74 €	- 2,521.73 €	-9.46
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	43.00 €	306.95 €	178.02 €	331.00 €	152.98 €	85.93
<i>Inkasimi Total €</i>	18,885.45 €	20,683.47 €	26,841.49 €	24,472.74 €	- 2,368.75 €	-8.82
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	1,426	1,449	1,456	1,462	6	0.41
<i>% e inkasimit</i>	92.35	85.18	98.36	114.58	16.22	16.49
<i>Shpenzimet</i>	27,772.98 €	29,315.06 €	27,862.23 €	29,914.67 €	2,052.44 €	7.37
<i>Pagat</i>	24,619.95 €	24,908.85 €	25,648.11 €	25,177.63 €	- 470.48 €	-1.83
<i>Rryma elektrike</i>	1,961.41 €	1,019.43 €	917.98 €	1,784.12 €	866.14 €	94.35
<i>Shpe. e derivateveve</i>	173.64 €	373.17 €	35.92 €	227.28 €	191.36 €	532.74
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	485.84 €	1,492.81 €	460.76 €	572.44 €	111.68 €	24.24
<i>Miremb. e automjeteve</i>	43.50 €	76.50 €	74.62 €	1,262.14 €	1,187.52 €	1,591.42
<i>Shpen. E taksave</i>	- €	685.87 €	- €	- €	- €	#DIV/0!
<i>Kemikalet</i>	- €	223.68 €	223.73 €	- €	- 223.73 €	-100.00
<i>Shpenzimet tjera</i>	488.64 €	534.75 €	501.11 €	891.06 €	389.95 €	77.82
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	152,010	200,135	205,818	197,930	(7,888)	-3.83
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	83.89	83.93	82.46	86.08	3.62	
<i>Mbulimi operativ</i>	0.68	0.71	0.96	0.82	(0.15)	
	- 8,887.53 €	- 8,631.59 €	- 1,020.74 €	- 5,441.93 €	- 4,421.19 €	

RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE
TM1-TM2-TM3-TM4-2018

● **HIDROREGJIONI JUGOR**

MUAJI	TM1-2018	TM2-2018	TM3-2018	TM4-2018	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	3,776,620	4,401,329	4,737,102	4,123,241	(613,861)	(12.96)
<i>Prodhimi - l/sec</i>	486	560	596	519	(77)	(12.96)
Faturimi m3	1,617,733	1,888,289	2,047,211	1,796,648	(250,563)	(12.24)
<i>Faturimi l/sec</i>	208	240	258	226	(32)	(12.24)
<i>Faturimi nga uji €</i>	960,071.15 €	1,096,123.63 €	1,169,803.96 €	1,068,315.09 €	- 101,488.87 €	(8.68)
<i>Faturimi- te tjera €</i>	16,355.10 €	16,030.31 €	17,710.47 €	22,457.46 €	4,746.99 €	26.80
Faturimi Total €	976,426.25 €	1,112,153.94 €	1,187,514.43 €	1,090,772.55 €	- 96,741.88 €	(8.15)
<i>Inkasimi nga uji €</i>	879,666.28 €	931,726.03 €	1,151,877.02 €	1,146,366.13 €	- 5,510.89 €	(0.48)
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	7,577.97 €	13,654.88 €	8,579.81 €	11,834.43 €	3,254.62 €	37.93
Inkasimi Total €	887,244.25 €	945,380.91 €	1,160,456.83 €	1,158,200.56 €	- 2,256.27 €	(0.19)
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	46,584	46,977	47,628	48,591	963	2.02
<i>% e inkasimit</i>	91.63	85.00	98.47	107.31	8.84	8.98
Shpenzimet	878,812.31 €	859,473.75 €	918,047.41 €	982,493.68 €	64,446.27 €	7.02
<i>Paqat</i>	499,964.12 €	497,351.16 €	524,102.27 €	548,598.74 €	24,496.47 €	4.67
<i>Rryma elektrike</i>	203,782.44 €	207,859.77 €	223,233.78 €	216,732.08 €	- 6,501.70 €	(2.91)
<i>Shpe. e derivateveve</i>	20,199.74 €	17,922.43 €	18,988.90 €	28,764.23 €	9,775.33 €	51.48
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	77,657.73 €	50,387.00 €	60,625.26 €	74,205.85 €	13,580.59 €	22.40
<i>Miremb, e automjeteve</i>	9,176.59 €	6,411.87 €	14,840.03 €	19,469.80 €	4,629.77 €	31.20
<i>Shpen. E taksave</i>	18,479.24 €	22,690.75 €	23,403.44 €	23,405.82 €	2.38 €	0.01
<i>Kemikalet</i>	3,531.21 €	2,946.81 €	2,407.61 €	4,111.41 €	1,703.80 €	70.77
<i>Shpenzimet tjera</i>	46,021.24 €	53,903.96 €	50,446.12 €	67,205.75 €	16,759.63 €	33.22
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	2,158,887	2,513,040	2,689,891	2,326,593	(363,298)	(13.51)
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	57.16	57.10	56.78	56.43	(0.36)	(0.63)
<i>Uji I pafaturuar l/sec</i>	277.63	319.63	338.40	292.70	(45.70)	
Mbulimi operativ	1.01	1.10	1.26	1.18	(0.09)	
	8,431.94 €	85,907.16 €	242,409.42 €	175,706.88 €	- 66,702.54 €	

STRUKTURA ORGANIZATIVE
KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A. PRIZREN

